

Shkaqet e shfaqjes së dhunës në sportin kosovar

*Shemsedin Vehapi**

*Hazir Salihu***

*Vullnet Ameti****

*Valbona Zeqa-Rexhepi*****

Përmbledhje

Nisur nga fakti që sporti paraqet vlerë kulturore dhe shpirtërore të çdo shoqërie dhe civilizimit njerëzor, dhe si i tillë kërkon një trajtim më të thellë dhe shumëdimensional të hulumtimit të faktorëve dhe fenomeneve të cilët janë të ndërlidhur me sport dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë në shkallën e zhvillimit të sportit në mjedise dhe në shoqëri të caktuara. Sporti kosovar, si çdo veprimtari tjetër, ka kaluar në fazën e vështirë të rrethanave të krijuara si në periudhën e paraluftës po ashtu edhe të pasluftës. Si rezultat i këtyre rrethanave sporti ka ngecur akoma në nivel jo të kënaqshëm dhe vazhdon të shoqërohet me fenomene të cilat janë brengosëse dhe dëmtojnë jo vetëm imazhin e sportit por edhe të vetë shoqërisë kosovare. Njëra ndër dukuritë më të shëmtuara që vazhdon edhe më tej të jetë shumë e pranishme dhe në përmasa të theksuara, është dhuna në spektaklet sportive, e cila paraqitet në forma të ndryshme dhe nga akterë të ndryshëm. Edhe pse për dhunën dhe dëmin që shkakton sporti, dhe imazhit të tërësishëm, është folur dhe debatuar mjaft, trajtimi i saj akoma nuk është bërë në formën e duhur profesionale dhe shkencore, dhe nuk janë bërë përpjekje institucionale që të hulumtohen shkaktarët të cilët janë burimi i kësaj dukurie. Duke u nisur nga ky fakt, ekspertët e lëmit të Kulturës Fizike dhe Sportit, duhet të krijojnë qasje shkencore dhe institucionale të hulumtimit të kësaj dukurie. Qendra për Studime – Hulumtime në Sport, ka hartuar një projekt hulumtues i cili

* *Dr. sc. Shemsedin Vehapi - UP, AAB.*

** *Dr. sc. Hazir Salihu - AAB.*

*** *Dr. sc. Vullnet Ameti - AAB.*

**** *Mr. sc. Valbona Zeqa-Rexhepi - AAB.*

kryesisht është i bazuar në mbledhjen e opinioneve nga akterë dhe kategori të ndryshme të cilët janë drejtpërdrejt të involvuar në sport dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë janë të përfshirë në ngjarjet e dhunshme në spektaklet sportive. Për këtë qëllim është përpiluar pyetësori, i cili ka për qëllim grumbullimin e opinioneve të akterëve kryesorë në sport, siç janë: simpatizuesit, sportistët, pedagogët (trajnerët), gjyqtarët – arbitrit, donatorët, menaxherët e klubeve, përfaqësuesit e Federatave Sportive dhe Komiteti Olimpik Kosovar. Projekti përfshinte numrin prej 800 të anketuarve nëpër të gjitha qytetet e Kosovës, dhe opinionet e grumbulluara nga të anketuarit kanë ofruar një bazë të mirë të informacioneve dhe orientimit të një projekti më të gjerë, i cili do të ndihmonte në elaborimin më të thellë të shkaktarëve dhe do të ndihmonte në hartimin e një strategjie për parandalimin dhe flakjen e dhunës në tërësi nga fushat tona sportive.

Fjalët kyç: dhuna, sporti kosovar, agresiviteti, gjyqtarët, profesionalizmi.

1. HYRJE

Fenomeni i dhunës është trajtuar nga shkencëtarë të fushave të ndryshme dhe si rezultat i këtij trajtimi janë paraqitur teori të ndryshme të cilat e kanë trajtuar dhe shpjeguar dhunën në varësi nga këndi dhe fusha e trajtimit të saj. Dhuna në fushat sportive në Kosovën e pasluftës ka qenë dhe vazhdon të jetë dukuri e cila vazhdimisht shfaqet bashkë me spektaklet sportive. Edhe pse dhuna është dukuri e cila shfaqet dhe e përcjell sportin në tërë botën, prapë se prapë përmasat e shfaqjes së saj në sportin kosovar janë me të vërtetë brengosëse. Me arsye, disa individë thonë se sportistët e shfaqin agresivitetin si rezultat i mungesës së kulturës apo shpirtit sportiv. Pra “agresiviteti dhe dhuna si sjellje negative që dalin nga lojtarët brenda fushave e stadiumeve sportive”, është bërë temë që zgjon interesimin e shumë sportdashësve, spektatorëve, gazetarëve, analistëve dhe shumë njerëzve të tjerë qofshin ata fëmijë, të rinj apo të moshuar, të cilët më pak merren me aktivitete sportive. Në të vërtetë kjo çështje ka dimensionet e saja të shumta, pikëpamje të ndryshme, shkaqe

të shumëllojshme, që gjithsesi duhet t'i njohim shkaqet, motivet dhe t'i kuptojmë drejt faktorët rrënjësor të kësaj problematike që do të na mundësojë zgjedhjen e rrugëve dhe mekanizmave relevantë për të ndihmuar në zvogëlimin dhe eliminimin e kësaj dukurie negative. Fenomeni i agresivitetit dhe dhunës në sport më së tepërmi është evident në garat sportive, si rezultat i ekstremizmit që luan një rol të madh në zgjerimin e kësaj dukurie të shëmtuar. Si dëshmitarë të rrjedhave sportive shohim se ky fenomen ka marrë përmasa të mëdha, andaj për të kuptuar dhe komentuar drejt agresivitetin dhe dhunën në sport, nuk mjafton studimi njëdimensional, por duhet studiuar edhe nga aspekti etik, edukativ, psikologjik, social, shoqëror etj.

Disa studiues të sportit na bëjnë të ditur se agresiviteti dhe dhuna në sport, janë prezent që nga fillimi i aktiviteteve sportive, me fjalë të tjera garat sportive janë shoqëruar me forcë, dhunë ose ndonjëherë kanë përfunduar në mënyrë skandaloze. Të gjitha teoritë e dhëna për sjelljen agresive dhe të dhunshme në sport mund të përmbliidhen në tri grupe.¹ Teoria biologjike e propozuar dhe zhvilluar nga Konrad Lorenz e shpjegon agresionin si karakteristikë bazë e qenies njerëzore, dhe si e tillë sporti paraqet një formë të pranuar sociale, përmes së cilës shkarkohet agresioni i grumbulluar.

Teoria psikologjike e shpjegon dhunën si rezultat i frustrimit situacional. Frustrimi paraqitet atëherë kur pengohen përpjekjet e individit apo grupit për të realizuar një qëllim të caktuar.²

Teoria e tretë është të mësuarit mbi faktorët socialë si shkaktarë kryesorë të dhunës në sport, si dhe shpjegon sjelljen agresive të sportistëve të ndërtuar në bazë të modelit të caktuar i cili mund të fuqizohet me anë të shpërblimeve dhe mbështetjeve që bëhen nga faktorë të ndryshëm.³

¹ Terry, Peter C. and Jackson, John J. (1985) The Determinants and Control of Violence in Sport. *Quest*, 37 (1) 27-37

² Leonard, Wilbert Marcellus. (1988) *A Sociological Perspective of Sport* (Third Edition). New York, Macmillan Publishing Company.

³ Leonard, Wilbert Marcellus. (1988)

2. QËLLIMI DHE DETYRAT E STUDIMIT HULUMTUES

Qëllimi i këtij eksperimenti apo studimi, është konstatimi i disa faktorëve të rëndësishëm që shkaktojnë (paraqesin) dhunën dhe agresivitetin në aktivitetet tona sportive.

Përshkrimi i projektit mund të definohet në përpjekjet që do të bëhen me arritjen e njohjes së faktorëve kryesorë, të cilët ndikojnë në shfaqjen e dhunës në sport shikuar nga prizma e akterëve të drejtpërdrejtë në aktivitetet sportive.

2.1. Qëllimi i këtij studimi mund të përkufizohet në:

Grumbullimin e opinionëve të aktorëve kryesorë në sport, siç janë: simpatizuesit, sportistët, pedagogët (trajnerët), gjyqtarët – arbitrit, donatorët, menaxherët e klubeve, përfaqësuesit e federatave sportive dhe Komiteti Olimpik Kosovar. Detyrë parësore e këtij projekti është që me anë të identifikimit të shkaktarëve kryesorë mundësisht të ndikohet deri te parandalimi i shfaqjes së dhunës dhe agresivitetit nëpër fushat tona sportive.

2.2. Mënyra e zbatimit të hulumtimit – eksperimentit *Modeli (mostra) e entiteteve*

Projekti përfshinte numrin prej 800 të anketuarve nëpër të gjitha qytetet e Kosovës, nga të cilët 730 gjejmësisht 91.25 % prej tyre janë përgjigjur pozitivisht. Nëpër të gjitha qendrat tona janë testuar pedagogë (trajnerë), simpatizues, sportistë, donatorë, gjyqtarë – arbitra, përfaqësuesit e Federatave të Sportit dhe Komitetit Olimpik Kosovar.

Në pyetësorin anonim është përdorur metoda e anketimit të drejtpërdrejtë, (face to face), secila pyetje përmbante pesë alternativa për çdo përgjigje: **Alternativa e parë:** Nuk pajtohem fare, **Alternativa e dytë:** Pajtohem pjesërisht, **Alternativa e tretë:** Pajtohem, **Alternativa e katërt:** Pajtohem plotësisht dhe **Alternativa e pestë:** Nuk e di.


3. Metodologjia e punës – përpunimi i rezultateve të arritura

Përpunimi i të dhënave nga pyetësorët janë bërë me programin Microsoft Office Excel 2003. Diagramet (grafikonët) janë përpunuar me programin Microsoft Office Word 2003. Zbërthimi i shifrave në përqindje është bërë me anë të formulës e cila përdoret për rregullimin e përqindjes së shifrës numerike. Përqindja e secilës pyetje (grafikonëve) është rregulluar në bazë të formulës matematiko-statistikore: $b \times 100/a$.

4. REZULTATET E ARRITURA DHE INTERPRETIMI I TYRE


Graf. 1. Të merren masa për parandalimin e dhunës në sportin tonë:

Me paraqitje të përqindjes mjaft të lartë, përgjigja në këtë grafikon rezulton mjaft pozitivisht, si vijon: Sportistët përgjigjen në alternativën e katërt, d.m.th. pajtohen plotësisht me 76.74%, po ashtu edhe trajnerët me 68.96%, si dhe simpatizuesit me 66.67%. Nga kjo pasqyrë vërehet se të gjitha kategoritë e përfshira në sport janë të vetëdijshme për gjendjen dhe shprehin bindjen e plotë që të merren masat e duhura për parandalimin e dhunës dhe agresivitetit gjatë aktiviteteve tona sportive.




Graf. 2. Shumica e kuadrove që punojnë nëpër klube nuk e kanë shkollimin e duhur profesional (adekuat):

Me përqindje mjaft të lartë, donatorët më saktësisht arbitrit, na bëjnë të ditur se në të ardhmen duhet që nëpër klube sportive të mbretërojë profesionalizmi. Përgjigja rezultoi mjaft pozitivisht dhe përqendrohet në alternativën e dytë; donatorët me 72.72 %, pajtohen pjesërisht, ndërsa në alternativën e katërt gjyqtarët-arbitrit me 52.63 %, pajtohen plotësisht, meqë nëpër klubet tona sportive kryesisht punojnë kuadro jo profesionalë.




Graf. 3. A mendoni se në sportin Kosovar dhuna është akoma në nivelin brengosës?

Përgjigja në këtë pyetje rezultoi pozitivisht si vijon: Kryesitë e klubeve përkatësisht sportistët me 57.36% përgjigjen në alternativën e katërt, çka do të thotë se pajtohen plotësisht dhe janë të mendimit që akoma dhuna dhe agresiviteti mbretëron në terrenet tona sportive. Pra, gjithsesi duhet të ndërmerren masa në këtë drejtim, sepse vërtet është mjaft brengosëse situata gjatë organizimit të aktiviteteve sportive.




Graf. 4. Gjyqtarët – Arbitrit janë të korruptuar dhe janë jo objektivë në ndarjen e drejtësisë:

Përgjigja në pyetjen e radhës rezulton si vijon: Në alternativën e parë, gjyqtarët – arbitrit nuk pajtohen fare me 57.89 %, e mohojnë se janë të korruptuar, ndërsa Federatat Sportive me 56.52 %, pajtohen pjesërisht dhe demantojnë të kundërtën nga arbitrit, në alternativën e katërt sportistët pajtohen plotësisht me 51.93 %, çka do të thotë se janë të bindur që arbitrit janë jo objektivë (të korruptuar) gjatë ndarjes së drejtësisë. Gjyqtarët duhet të drejtohen në institucionet profesionale për edukim-mësim në shkallë më të lartë.




Graf. 5. Shikuesit janë më shumë të prirë për të shkaktuar dhunë në terrenet (fushat) tona sportive:

Bazuar në përqindjen e paraqitur në grafikon, përgjigjja është përqendruar në alternativën e dytë dhe të pestë si vijon: Përfaqësuesit e Federatave Sportive me 56.52 % dhe trajnerët me 51.72 %, pajtohen pjesërisht, sepse disa nga shikuesit janë të prirë që të shkaktojnë dhunë të papritur nëpër fushat tona sportive. Ndërsa, donatorët e klubeve sportive nuk e dinë se a janë nxitës të dhunës dhe agresivitetit shikuesit nëpër stadiumet – fushat tona sportive, d.m.th. në alternativën e pestë me 54.54 %, rezultojnë anonim në përgjigjen e tyre. Pra, udhëheqja e klubit amë duhet të organizojë takime me simpatizues, me qëllim të edukimit të tyre në frymën sportive.




Graf. 6. Edhe zyrtarë të lartë të Federatave janë të involvuar në parregullsi të ndryshme të cilat sjellin deri te konfliktet:

Në grafikonin e radhës, përgjigjja është përqendruar në alternativën e katërt, që rezulton pozitivisht si vijon: Donatorët me 54.54 % dhe kryesitë e klubeve me 52.38 %, pajtohen plotësisht, sepse edhe zyrtarët e lartë të Federatave Sportive, janë të involvuar në parregullsi të ndryshme që sjellin deri te konfliktet nga më të ndryshmet. Kjo tregon se akoma mbretëron situatë alarmante nëpër Federatat tona sportive, të cilat kanë zgjedhur kuadro joprofesionale, çka rezulton se involvimi i tyre në parregullsi të ndryshme është gjithnjë prezent.




Graf. 7. Niveli i sportit tonë në krahasim me vendet e rajonit:

Përgjigjja në grafikun e radhës rezulton mjaft pozitivisht, konkretisht në alternativën e katërt, çka do të thotë se, simpatizuesit me 60.51 % dhe sportistët me 54.26 %, nuk janë të kënaqur me nivelin e sportit tonë në krahasim me vendet e rajonit. Duhet që institucionet tona të interesohen më tepër që në klubet tona të sjellin kuadro më profesionalë për ngritjen e nivelit të sportit tonë në krahasim me vendet e rajonit.




Graf. 8. Shkakun e dhunës qëndron edhe në stimulimin e dobët material të sportistëve:

Përgjigjja në këtë pyetje qëndron në alternativën e dytë dhe të katërt si vijon: Arbitrat me 47.36 %, përkatësisht donatorët me 45.45 %, pajtohen pjesërisht, ndërkaq sportistët me 46.51 %, pajtohen plotësisht se dhuna dhe agresiviteti qëndron edhe në stimulimin e dobët material që iu ofrohet lojtarëve – sportistëve tanë. Detyra jonë mbetet që në të ardhmen duhet të gjejmë forma dhe mënyra për stimulimin e sportistëve tanë, pa të cilët nuk kemi mundësi që të organizojmë apo zhvillojmë ndonjë aktivitet sportiv, me një fjalë as që do të mbijetonte sporti ynë.




Graf. 9. Raportet e zyrtarëve të Federatave Sportive me trajnerët e klubeve dhe arbitrit:

Në këtë grafikon përgjigjet janë adresuar në alternativën e dytë dhe të tretë, që rezultojnë, pozitivisht, si vijon: Trajnerët me 51.72 %, shprehen se janë pjesërisht të kënaqshëm, ndërsa donatorët e klubeve sportive me 45.45 %, janë plotësisht të kënaqur me raportet e zyrtarëve të Federatave Sportive, me trajnerët dhe arbitrit. Duhet ndikuar në këtë drejtim që raportet ndërmjet tyre të jenë në nivelin e duhur.



Graf. 10. Numëroni 3 shkaktarët kryesorë të kësaj dukurie negative:

Sipas rezultateve të paraqitura në këtë grafik, pjesa dërmuese e të anketuarve kanë paraqitur mendimin e tyre në shumë alternativa, por më së shumti kanë dhënë përgjigje negative për gjykimin tendencioz (të njëanshëm) jo objektiv me 24%, tifozët me 14%, Federatat me 10%, jo profesionalizmi me 9%, e kështu me radhë, siç i pasqyron grafikoni. Pra, edhe një dëshmi për arbitrit tanë, që të jenë më të saktë dhe më korrektë në ndarjen e drejtësisë dhe të përkujdosen maksimalisht për gabimet e tyre eventuale, që të mos nxisin sjelljen agresive dhe dhunën e papritur e të padëshiruar nga të gjithë të pranishmit; pedagogët (trajnerët), simpatizuesit, sportistët, menaxherët, përfaqësuesit e Federatave Sportive, donatorët e klubeve sportive etj. Kjo rezulton se gjyqtarët duhet të shfaqin interesim, që të vijnë shkollimin akoma në shkallë më të ngritur profesionale.



5. REZYME

Nga analiza e rezultateve të fituara me anë të llogaritjes së përqindjes së opinionëve të fituara mund të vërehet se ekzistojnë mendime dhe qëndrime të ndryshme sa i përket bindjeve mbi shkaqet e dhunës në sport. Nga një analizë përmbledhëse mund të konstatohet se:

- Të gjitha kategoritë të cilat janë të përfshira qoftë si akterë të drejtpërdrejtë apo edhe si menaxhues dhe mbështetës të aktiviteteve sportive, janë të vetëdijshëm për faktin se dhuna e shfaqur në terrenet tona sportive ende ka përmasa të cilat janë brengosëse, dhe se në një nivel të konsideruar janë të bindur se është e domosdoshme që të merren masat e nevojshme për parandalimin e saj.
- Shumica e kategorive të të anketuarve kanë shprehur bindjen e lartë se shkaktarët kryesorë të dhunës në sportin kosovar janë jo profesionalizmi në udhëheqje dhe ndarja jo korrekte e drejtësisë në terrenet sportive.
- Po ashtu është vërejtur edhe një bindje se edhe strukturat e larta udhëheqëse të Federatave Sportive janë të involvuar në disa parregullsi, të cilat në mënyrë të

drejtpërdrejtë ndikojnë në funksionimin jo të mirë të organizimit të aktiviteteve sportive.

Duke u mbështetur në opinionet e grumbulluara sugjerojmë që:

- Të mos neglizhohet roli negativ që ka dhuna si dukuri mjaft e shëmtuar e cila dëmton imazhin e sportit tonë, por trajtimit të kësaj problematike t'i qasemi në mënyrë shumë aktive dhe profesionale duke ndërmarrë aktivitete të ndryshme qoftë të karakterit hulumtues-shkencor qoftë praktiko-profesional.
- Të iniciohet hartimi i një strategjie gjithëpërfshirëse nga institucione relevante shkencore si dhe menaxhuese të sportit, e cila do të ofronte një platformë të mekanizmave dhe instrumenteve në luftimin dhe parandalimin e mëtutjeshëm të dhunës.
- Meqenëse është e rëndësishme që shteti ynë i ri të përfaqësohet në mënyrë të denjë në arenën ndërkombëtare, duke e plotësuar rolin e sportit si ambasador i vlerave të një kombi, atëherë institucionet sportive kosovare duhet që t'i kushtojnë rëndësi të veçantë çështjes së profesionalizimit të kuadrove udhëheqëse në sport si dhe kualifikimeve valide të personave të cilët ndajnë drejtësinë dhe që ndikojnë drejtpërdrejt në krijimin e kulturës të sjelljes së sportistëve në terrenet sportive.
- T'i kushtohet rëndësi e veçantë çështjes së ndërtimit të raporteve në mes të shikuesve dhe klubeve sportive në frymën e një kultivimi të mbështetjes në suaza të normave të lejuara dhe fer-playit sportiv.
- Që klubet sportive në programet përgatitore me sportistët e rinj t'i kushtojnë rëndësi më të madhe aspektit edukativ dhe formimit të vlerave pozitive morale, si dhe aspektit të përgatitjes së drejtë psikologjike të sportistëve.

Sipas mirësjelljes në frymën sportive vlen që:⁴

- Të qetësojmë njëri-tjetrin, kështu duhet të veprojnë pedagogët (trajnerët), sportistët, gjyqtarët-arbitrit, simpatizuesit, menaxherët, donatorët, organizatorët, etj.
- Të përshëndetemi para fillimit të takimit (lojës) me publikun dhe me kundërshtarët, të ecim drejt njëri-tjetrit dhe t'i shtrijmë dorën duke u shprehur suksese.
- Të marrim përsipër përgjegjësinë për spektatorët tanë dhe për atë që ndodh gjatë aktiviteteve sportive.
- Edhe mbas përfundimit të lojës të përshëndetemi me publikun dhe kundërshtarët, pa marrë parasysh humbjen apo fitoren.
- Gjatë tërë kohës së aktiviteteve sportive të kujdesemi maksimalisht që mos të ndodhin fyerje, nënçmime apo ofendime të ndryshme.
- Pas çdo ndërhyrjeje të parregullt t'i kërkojmë falje njëri tjetrit.

Pra, të jemi më vigjilentë, më të disiplinuar dhe më korrektë në ndarjen e drejtësisë gjatë aktiviteteve sportive, të gjithë së bashku ta parandalojmë njëherë e përgjithmonë, ta flakim rrënjësisht paraqitjen e dhunës dhe agresivitetit nëpër stadione dhe terrenet tona sportive. Ky hulumtim ka rëndësinë e vetë për faktin se paraqet përpjekjen e parë në hulumtimin e dukurisë së dhunës dhe, natyrisht se një hulumtim më gjithëpërfshirës i këtij fenomeni është më se i nevojshëm, ku numri i ndryshoreve dhe hulumtimi i lidhshmërisë shkak-pasojë do të jetë i bazuar në analizën e fakteve nga rastet dhe evidenca të dhunës në ngjarjet sportive.

Studimi – hulumtimi në fjalë, do të hapë perspektiva të reja në të ardhmen, meqë do të mbetet në funksion apo shërbim të zhvillimit shoqëror e mbarëkombëtar.

⁴ H-J. Rojahn: Revistë për paqen dhe heqjen e dhunës, Denmark – 2003.

Bibliografia

- Allport, G.W Personality:** A Psychological interpretation, thirr reprint-Landon. Redwood Press Ltd. London – 1981.
- Ameti, Vullnet:** Dhuna dhe agresiviteti në sport, pun. sem. Prishtinë – 2000.
- Bosnar, K.F. Prot:** Struktura kognitivnih sposobnosti i stupanj angaziranosti u Sportu. Kineziologija, br.2. str.(61-64). 1987 – Zagreb.
- Coakley, Jay J.** (1982) Sport in Society, Issues and Controversies (Second Edition). St. Louis: C.V. Mosby Company.
- Debendotte, Valerie.** (1988, March) Spectator Violence at Sports Events: What Keeps Enthusiastic Fans in Bounds? The Physician and Sportsmedicine, 16 (4) 203- 11. EJ 372 800.
- Wandzilak, Thomas** (1985). Values Development Through Physical Education and Athletics. Quest, 37 (2) 176-85.
- Gërmizaj, Mahmut:** Psikologjia e Sportit, Prishtinë – 1996.
- Garland, D.J. and J.R. Barry:** Sport expertise: The cognitive advantage.
- Hellstedt, Jon C.** (1988, April) Kids, Parents and Sport: Some Questions and Answers. The Physician and Sportsmedicine, 16 (4) 59-71. EJ 376 620.
- H-J. Rojahn:** Revistë për paqen dhe heqjen e dhunës, Denmark – 2003.
- Kerr, John H.** Aggressive Behavior; Jan/Feb 2009, Vol. 35 Issue 1, p41-48, 8p
- Lewis, Jerry M.** Revista de Psicologia Social; Jan 2007, Vol. 22 Issue 1, p63-87, 25p
- Lee, Martin J.** (1985) From Rivalry to Hostility Among Sp Fans. Quest, 37 (1) 38- 49
- Leonard, Wilbert Marcellus.** (1988) A Sociological Perspective of Sport (Third Edition). New York, Macmillan Publishing Company.
- Mikić, Branimir:** Osnove Psihologije Sporta. 1996 – Tuzla. B i H.
- Poulton, Emma.** Media, Culture & Society; Jan 2007, Vol. 29 Issue 1, p151-164, 15p
- Roskosz, Francis M.** (1988, Late Winter) The Paradoxes of Play. The Physical Educator, 45 (1) 5-13. EJ 371 284.
- Salihu, Hazir:** Krijimi – Përshkrimi i Qendrës për Studime në Sport, f.3, Projekti Hulumtues, UAAB, Prishtinë – 2008.
- Spaaaj, Ramón.** Journal of Sport & Social Issues, Nov 2008, Vol. 32 Issue 4, p369-392,
- Terry, Peter C. and Jackson, John J.** (1985) The Determinants and Control of Violence in Sport. Quest, 37 (1) 27-37.

Burimet nga faqet e internetit:

<http://www.internationalbasketball.com/>; <http://www.internationalfootball.com/>; (për herë të fundit 25/12/2008)

http://www.olympic.org/uk/organisation/if/fi_uk.asp?id_federation=28; (për herë të fundit më 25/12/2008)

http://www.ihf.info/front_content.php?idcat=57 (për herë të fundit më 0501/2009)

<http://web.ebscohost.com/ehost/detail?vid=9&hid=13&sid=e037da-da-3ded-45a8-a0b7d1f99a57ccdc%40sessionmgr2&bdata=JnNpd-GU9ZWhvc3QtbGl2ZQ%3d%3d#db=aph&AN=34930922> (për herë të fundit më 19/01/2009)

<http://web.ebscohost.com/ehost/detail?vid=9&hid=13&sid=e037da-da-3ded-45a8-a0b71f99a57ccdc%40sessionmgr2&bdata=JnNpd-GU9ZWhvc3QtbGl2ZQ%3d%3d#db=aph&AN=35716189> (për herë të fundit më 19/01/2009)